

KUD 005.5

**KUPTIMI, PËRMBAJTJA DHE RËNDËSIA E BURIMEVE TË
FINANCIMIT TË BIZNESEVE TË VOGLA DHE TË MESME**

*MSc. Fjolla Trakaniqi,
fjollatrakaniqi@gmail.com*

Abstrakt

Kuptimi, përmbajtja dhe rëndësia e burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë trajton disa karakteristika të definicioneve të menaxhimit të burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme sipas literaturës bashkëkohore, menaxhimin e burimeve financiare në kuadër të sistemit të menaxhimit të ndërmarrjes, njohuri dhe përvoja të menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në biznesin bashkëkohor si dhe rolin e ndërmarrësit dhe menaxherit në zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve të financimit.

Fjalët kyçe: Burime të financimit, menaxhim, financim, biznes, ndërmarrës dhe menaxher.

JEL kualifikimi: G, M2, M20, NO, P34.

Hyrje

Në këtë punim janë paraqitur katër tema që kanë të bëjnë me kuptimin, përmbajtjen dhe rëndësinë e menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme. Të gjitha bizneset, pa marrë parasysh a janë të vogla apo të mesme kanë nevojë për burime të financimit si dhe nevojën për tu menaxhuar. Menaxhimi përfshinë të gjithë procesin menaxhues në një ndërmarrje. Çdo aktivitet i menaxhmentit financiar si investimi, financimi apo shpërndarja e fitimit përfshijnë shumë detyra që kryhen në ndërmarrje. Për marrjen e vendimit financiar në ndërmarrje menaxherët duhet të njoftohen me gjendjen e ndërmarrjes dhe me rezultatet financiare të arritura.

Përveç kësaj në këtë punim janë paraqitur edhe përvoja të menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në biznesin bashkëkohor e veçmas të disa vendeve të zhvilluara dhe vendeve me ekonomi në tranzicion.

I. Disa karakteristika të definicioneve të menaxhimit të burimeve financiare te bizneseve të vogla dhe të mesme sipas literatures bashkëkohore

Mbi menaxhimin janë dhënë lloje të ndryshme të definicioneve nga ato më të thjeshtat si "menaxhimi është ajo çka menaxherët bëjnë" gjer tek ato më të detajuarat. Njeriu i cili kryen këtë funksion njihet si menaxher ose udhëheqës.

Menaxhimi, (*ang.: management - sq.: udhëheqje, prirje, lat.: manum agere = prijë me dorë*), nënkupton planifikimin, organizimin, udhëheqjen, koordinimin dhe kontrollin e një organizmi (të përbërë nga një ose më shumë njerëz ose grupe) për të arritur qëllimin e caktuar.⁹³

Koncepti i sotëm tregon se menaxhimi ka 3 karakteristika kryesore: është një proces që përfshinë një seri aktiviteteve të vazhdueshme dhe të ndërlidhura, përqendrohet në arritjen e objektivave organizative dhe synon arritjen e këtyre objektivave dhe burimeve tjera të organizatës.

Sipas disa studjuesve dhe autorëve bashkëkohorë, "Menaxhimi është procesi i arritjes së objektivave organizative duke punuar me dhe nëpërmjet njerëzve dhe burimeve të tjera organizative".

I.1. Definicionet e disa mendimtarëve mbi menaxhimin⁹⁴

Peter Ferdinand Drucker (19 nëntor 1909 - 11 nëntor 2005) P. Drucker, për rëndësinë e menaxhimit, pohon se: "Përgjegjësia e menaxhimit në shoqërinë tonë është vendimtare jo vetëm për vet organizatën, por edhe për qëndrimin publik ndaj menaxhimit, për suksesin dhe statusin e tij, për të ardhmen e sistemit tonë ekonomik e social dhe për mbijetesën e organizatës si një institucion i pavarur".

Sipas P. Drucker menaxhimi ka tri detyra kryesore:

- Të realizojë qëllimin dhe misionin specifik të organizatës,
- Ta bëjë punën produktive dhe punëtori ta arrijë atë,
- Të menaxhojë impaktet dhe përgjegjësitë sociale.

Henri Fayol (29 korrik 1841, Istambull, - 19 nëntor 1925, Paris) konsideronte se menaxhimi përbëhet prej pesë funksioneve: planifikimi, organizimi, udhëheqja, koordinimi dhe kontrolli.⁹⁵

Mary Parker Follett (3 shtator 1868 - 18 dhjetor 1933) e definoi menaxhimin si "arti për realizimin e veprimeve përmes njerëzve".⁹⁶

⁹³ <http://sq.wikipedia.org/wiki/Menaxhimi>

⁹⁴ <http://www.slideshare.net/nicky201/menaxhim-pyetje-pergjigje>

⁹⁵ <http://sq.wikipedia.org/wiki/Menaxhimi>

⁹⁶ <http://sq.wikipedia.org/wiki/Menaxhimi>

George Rippey Stewart (31 maj 1895 – 22 gusht 1980) studjuesja e mirënjohur e menaxhimit, R.Stewart, në përpjekjet e sajë për të integruar definicionet e ndryshme të menaxhimit thekson: “Të menaxhosh do të thotë të vendosësh se çfarë të bësh dhe pastaj të vësh njerëzit e tjerë për t’i bërë”.

Sipas **Prof. Dr. Isak Mustafa** “Menaxheri është subjekt përmes të cilit veprimtari profesional mund të drejtojë diturinë, punën dhe kapacitetin e tij drejt rezultateve të përbashkëta dhe përmes të cilit zbulon nevojat, kapacitetet dhe mundësitë e ndërmarrjes anëtarë i të cilës është ai”.⁹⁷

Sipas **Prof. Dr. Isa Mustafa** “Menaxhmi definohet si proces dhe organ i cili është përgjegjës për shtruarjen e qëllimeve themelore, udhëheqjen dhe organizimin e realizimit të qëllimeve të shtruara”.⁹⁸

Brech e përcakton menaxhimin si "Një proces social që ka përgjegjësi për planifikimin dhe rregullimin efektiv dhe ekonomik të operacioneve të një organizate me qëllim që të arrihet një objektivë apo një detyrë e dhënë. Një përgjegjësi e tillë përfshinë:

Vlerësimin e gjendjes dhe marrjen e vendimeve për përcaktimin e planeve, për përdorimin e të dhënave, për kontrollin e performancës dhe të nivelit të progresit kundrejt planeve, udhëheqjen, integrimin, motivimin dhe mbikqyrjen e personelit të organizatës, i cili i kryen operacionet e sajë.

F. Luthanas dhe R. Hodgetts japin një përkufizim më të thjeshtë të menaxhimit: “Menaxhimi është procesi i përcaktimit të objektivave dhe i koordinimit të përpjekjeve të punonjësve për t’i arritur ato”.

C. S. George në lidhje me menaxhimin, ka theksuar: "Nga një pozitë pothuaj e panjohur në vitin 1900, menaxhimi sot është bërë një aktivitet qendror i epokës dhe ekonomisë sonë, një forcë e fuqishme dhe novatore në të cilën mbështetet shoqëria jonë në fushën materiale dhe mirëqenie kombëtare".

Johan Kotter ekspert amerikan thot: “Menaxherët nxjerrin vendime buxhetore dhe plane afatgjata”.

II. Funksioni i menaxhimit të burimeve financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme në kuadër të sistemit të menaxhimit të ndërmarrjes

Menaxhmi përfshinë të gjithë procesin menaxhues në një ndërmarrje duke u nisur nga planifikimi, punësimi, drejtimi, bashkërenditja, ekzekutimi e deri te kontrolli i sajë. Të gjitha aktivitetet financiare në një ndërmarrje janë të pranishme duke filluar nga furnizimi e deri te shitja dhe pagesa. Për realizimin e objektivave dhe detyrave të shtruara të ndërmarrjes ndërmirren

⁹⁷ Prof.Dr.Isak Mustafa, “Drejtori në udhëheqjen e biznesit”, 1993, Prishtinë. fq.20.

⁹⁸ Prof.Dr.Isa Mustafa, “Udhëheqja efiçienca dhe efektiviteti”, 2004, Prishtinë. fq.10.

një varg aktivitete. Këto aktivitete mund të grumbullohen në katër grupe:⁹⁹

- Aktivitetet që kanë të bëjnë me formulimin e strategjisë,
- Aktivitetet që kanë të bëjnë me investimin,
- Aktivitetet që kanë të bëjnë me financimin dhe
- Aktivitetet operative.

Në aktivitetet që kanë të bëjnë me formulimin e strategjisë menaxhmenti vendos qëllimet dhe detyrat e ndërmarrjes e kjo i mundëson gjetjen e alternativave më të mira për realizimin e qëllimeve, e qëllimi kryesor i ndërmarrjes është rritja e pasurisë së ndërmarrjes.

Aktivitetet që kanë të bëjnë me investimet e ndryshme përfshijnë marrjen e vendimeve të ndryshme për angazhimin e burimeve të mjeteve në forma të ndryshme.

Në aktivitetet e financimit të ndërmarrjes përfshihet marrja e vendimeve lidhur me financimin dhe shfytëzimi sa më racional i mjeteve në ndërmarrje. Në këto aktivitete njëherit përfshihet edhe zgjidhja e problemeve të cilat janë të lidhura me burimet e financimit, lartësia e mjeteve dhe struktura e mjeteve financiare.

Në realizimin e qëllimeve të ndërmarrjes në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon menaxhmenti financiar nëpërmes vendimeve që merr lidhur me investimet, financimin, dhe shpërndarjen e fitimit.

Çdo aktivitet i menaxhmentit financiar si investimi, financimi apo shpërndarja e fitimit përfshijnë shumë detyra që kryhen në ndërmarrje qoftë në afat të shkurtër apo të gjatë.

Aktivitetet e ndërmarrjes që lidhen me investimin brenda një afati të shkurtër përfshijnë drejtimin me para të gatshme dhe drejtimin me kërkesat dhe me rezervat. Aktivitetet që lidhen me investimin në afat të gjatë përfshijnë investimin në mjetet e përhershme, ndërtimin ose blerjen e mjeteve themelore dhe plasmanin afatgjatë financiar.

Aktivitetet që kanë të bëjnë me financimin e ndërmarrjes me afat të shkurtër përfshijnë kujdesin për likuiditetin vijues dhe ngarkesën afatshkurtër. Aktivitetet lidhur me financimin për afat të gjatë kanë të bëjnë me sigurimin e kapitalit te bankat, emisionin e fletobligacioneve dhe aksioneve etj. Lidhur me shpërndarjen e rezultatit të ndërmarrjes vendoset se cila pjesë e fitimit ndahet për pronarët e kapitalit, cila pjesë e fitimit mbahet për rezerva dhe cila pjesë mbahet për riinvestim.

Menaxhmenti financiar mirret me qeverisjen e financave të ndërmarrjes. Menaxhmenti bashkëkohor sot ka dimension tjetër dhe krijon pasqyrë të re të rolit dhe pozitës së menaxherit të financave. Menaxheri i financave ka marrë rolin e kërkuesit të mënyrës më efikase të shfytëzimit të

⁹⁹ Prof. Dr.Berim Ramosaj, Doc.Dr. Izet Zeqiri, "Menagement", 2003, Prishtinë, fq.81.

burimeve financiare. Që të kryej rolin e vet si menaxher financiar, menaxheri duhet të ketë lidhje me të gjitha funksionet afariste të ndërmarrjes. Për të shfrytëzu kapitalin dhe pasuritë e ndërmarrjes në mënyrë sa më efikase menaxheri i financave duhet t'i njeh mirë edhe fushat tjera të ekonomisë së ndërmarrjes.

Ekzistojnë dallime në mes të menaxhmentit klasik dhe menaxhmentit modern financiar. Menaxhmenti klasik financiar përfshinte vetëm çështjet e shfrytëzimit të burimeve të kapitalit të ndërmarrjes. Ndërsa, menaxhmenti financiar modern mirret me përcaktimin e masës së nevojshme, strukturës dhe mënyrës së shfrytëzimit të kapitalit të ndërmarrjes.

Mbështetur në kuptimin e menaxhmentit financiar bashkëkohor, elementet që përfshijnë esencën e punëve që dalin nga ky proces janë:

- Analiza e pozitës financiare të ndërmarrjes,
- Përcaktimi i sakt i strukturës dhe masës së mjeteve afariste,
- Përcaktimi i strukturës së kapitalit si burime financiare të mundshme.¹⁰⁰

Analiza e pozitës financiare të ndërmarrjes - Kjo analizë përfshinë analizën e bilancit të gjendjes, analizën e bilancit të suksesit si dhe raportet financiare të ndërmarrjes të shprehura në rezultatin afarist financiar.

Përcaktimi i sakt i strukturës dhe masës së mjeteve afariste - Këtu bëhet përcaktimi kuantitativ dhe kualitativ i mjeteve themelore dhe xhiruese të ndërmarrjes në kuadër të aktivitetit të bilancit të gjendjes. Për menaxherin e financave njohja e gjendjes nga e kaluara dhe planet reale të mundshme paraqesin kusht themelor për definimin e strukturës optimale të mjeteve afariste.

Përcaktimi i strukturës së kapitalit si burime financiare të mundshme Nevoja e përcaktimit dhe definimit të strukturës së kapitalit që përmban pasivi i bilancit të gjendjes paraqet marrëdhënjet midis burimeve të brendshme dhe të jashtme financiare njëherit edhe marrëdhënjet midis burimeve afatshkurtra dhe afatgjata të financimit.

Për marrjen e vendimeve financiare në ndërmarrje menaxherët duhet të njoftohen me gjendjen e ndërmarrjes në kohë të caktuar dhe me rezultatet financiare të arritura.

Për marrjen e vendimeve në lidhje me financimin e ndërmarrjes menaxhmenti duhet të disponoj me disa lloje të informacioneve edhe atë:

- Informacionet për fluksin e parave,
- Informacionet për qarkullimin e mjeteve gjiruese,
- Informacionet për qarkullimin e mjeteve të përgjithshme,
- Informacione lidhur me normën e kamatës,

¹⁰⁰ Prof.Dr.Berim Ramosaj, Doc.Dr.Izet Zeqiri, "Menagement", 2003, Prishtinë, fq.68.

- Informacionet në lidhje me shpenzimet e borxhit,
- Informacionet në lidhje me çmimin e kapitalit nga burimet interne,
- Informacionet në lidhje me liverazhin etj.

Nga këto informacione të lartpërmendura dhe informacionet tjera financiare menaxhmenti financiar krijon një bazë informative të shëndoshë për marrjen e vendimit në lidhje me financimin e ndërmarrjes.¹⁰¹

III. Disa njohuri dhe përvoja të menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në biznesin bashkëkohor

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX u krijuan kushte për trajtim më të madh të menaxhimit të ndërmarrjeve. Ndër teoricientet dhe biznismenët e parë që u morrën me këtë ishte biznesmeni britanik Robert Owen i cili ndërmorri disa reforma në fabrikën e tij të pambukut.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës filloi shkollimi i stafit drejtues në shkollat e biznesit. Kështu në fund të viteve të 60-ta më shumë se gjysma e drejtuesve të kompanive industriale e kanë pasur të kryer shkollimin special në lëmin e menaxhimit. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës edhe sot e kësaj dite është shumë i përhapur sistemi i konsultimit nga menaxhimi. Kështu, në këto shtete janë themeluar një numër i madh shoqatash dhe asociacionesh, të cilat punojnë në zhvillimin e teorisë dhe praktikës së menaxhimit, dhe atë zhvillimin e teorisë moderne të menaxhimit.

Vlen të përmendet vepra e Frederik Taylor (1856 - 1915) “Parimet e Menaxhimit Shkencor” (The Principles of Scientific Menagement) e cila u botua në vitin 1911. Pas Luftës së Parë Botërore, shkolla amerikane e drejtimit shkencor (e prirë nga Frederik Taylor) filloi të zgjerohet edhe jashtë kufijve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kjo shkollë gjeti aplikim edhe në shtetet europiane si në Gjermani, Britani të Madhe, Francë dhe disa shtete tjera. Në këto shkolla në fillim vëmendje e madhe iu kushtua biznesit e më vonë, me kalimin e kohës edhe organizimit të menaxhimit. Kështu, menaxhimi u ngrit në nivel të ndërmarrjes.

Inxhinjeri francez Henry Fayol (1841 - 1925) në veprën e tij “Administrata e Përgjithshme Industriale” (Administration Industrielle et Generale) paraqet disa rregulla dhe veprime administrative lidhur me afarizmin e ndërmarrjes në përgjithësi. Fajolli ka konsideruar se dituritë në udhëheqje mund të barten dhe udhëheqja mund të ligjërohet si lëndë. Sipas tij ekzistojnë disa parime të udhëheqjes të cilat do të duhej të jenë fleksibile

¹⁰¹ Prof.Dr.Berim Ramosaj, Doc. Dr. Izet Zeqiri, “Menagement”, 2003, Prishtinë, fq.149.

që të mund të paraqesin kahjet e mendimit menaxherik. Llojet e shkathtësive që u nevoiten menaxherëve varen nga pozita e tyre hierarkike. Me ngritjen në hierarki, shkathtësitë menaxherike bëhen gjithnjë më të rëndësishme. Nevoja për shkathtësi menaxherike varet edhe nga madhësia e organizatës. Udhëheqësve kryesor në firmën e madhe u nevoitet shumë më tepër menaxheri i shkathtët se sa udhëheqësve kryesor në ndonjë firmë të vogël.

Fajolli i ka ndarë operacionet afariste në gjashtë veprimtari dhe ato janë:

- Veprimtaria teknike - prodhimi dhe punimi i produkteve; fabrikimi dhe transformimi.
- Veprimtaria komerciale - blerja e lëndëve të para dhe shitja e produkteve; grupi i punëve komerciale detyrë e të cilave është sigurimi i lëndëve të para, materialeve dhe shitja e produkteve të gatshme.

Funksioni financiar - në ndërmarrje asgjë nuk bëhet pa intervenimin e tij. Është e nevojshme që ndërmarrja të ket mjete për personelin, për gjëra të palëvizshme, për veglat, për lëndët e para, për dividendat, për përmirësime të ndryshme, për rezerva etj.

Siguria - mbrojtja e njerëzve dhe e pasurisë; funksioni i sigurisë ka për detyrë që të mbrojë pasurinë dhe personelin nga vjedhjet, zjarri, përmytjet.

Funksioni i kontabilitetit, i cili ka për detyrë të paraqes gjendjen ekonomike në ndërmarrje; shënimin e shpenzimeve, profitin, pasiven dhe udhëheqjen e listave të bilancit.

Veprimtaria menaxherike, është “sistemi nervor i ndërmarrjes” që ka për detyrë lidhshmërinë dhe harmonizimin e punës së të gjitha funksioneve tjera.¹⁰²

III.1. Disa njohuri dhe përvoja nga financimi i bizneseve të disa vendeve të zhvilluara dhe vendeve me ekonomi në tranzicion

Qeveria Japoneze nëpërmes të organizatave financiare ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme u siguron mjete financiare me kushte të volitshme nga bankat private. Huatë jepen me kamatë të ultë, për mallrat me destinime të caktuara për teknologji, infrastrukturë mbrojtje të ambientit, kursim të energjisë etj. Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme u jepen garancione për kredi. Atyre u jepen kredi edhe nga institucionet shtetërore. Në këtë shtet funksionojnë shoqatat e garancioneve të kredisë. Këto shoqata garancionet e kredisë i japin prej 70% deri në 80% të kredisë së kërkuar.

¹⁰² Prof.Dr.Isak Mustafa, “Drejtori në udhëheqjen e biznesit”,1993, Prishtinë. fq.44.

Ligjet Japoneze u mundësojnë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme të shfrytëzojnë ndihmat për avancimin e menaxhmentit, përsosjen e strukturës së brendshme të organizimit, për investime në zhvillimin e bashkëpunimit të këtyre ndërmarrjeve me kompanitë e mëdha. Stimulohen aktivitetet në zhvillimin dhe aplikimin e programeve harduer dhe softuer, si dhe për themelimin e inkubatorëve të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Në Spanjë mbështetja financiare e biznesit është e drejtuar në këto aktivitete: subvencioni i projekteve hulumtuese, shfrytëzimi i huave pa kamatë, stimulimet për ndërmarrjet e rrezikuara nëpërmjet lirimit nga tatimet, kredive të volitshme për investime, gjetjes së lokacionit të volitshëm etj. Nëpërmjet fondit të solidaritetit japin kredi për themelimin e kooperativave punuese dhe të shoqërive të ndryshme aksionare.

Në Zvicër jepen ndihma për zhvillimin e informatikës financiare dhe ndihma për shfrytëzimin e kredive me kamata të ulta dhe për lirim nga tatimet. Ndërmarrjet e vogla mund të shfrytëzojnë ndihmë teknike dhe mbështetje nga kooperativat për garancionet e kredisë. Garancionet jepen për huatë bankare të destinuara për investime afariste.

Në Austri ndërmarrjet ndihmohen duke u siguruar kushte të volitshme të kredive, subvencioneve për hapjen e vendeve të reja të punës, ndihmë teknike pa pagesë, normë të ultë të tatimit në të ardhura dhe në vlerën e shtuar.

Në Itali ndihma financiare e ndërmarrjeve aplikohet në forma të ndryshme: shfrytëzohen fondet shtetërore, jepen ndihma për trajnim profesional, për ngritjen e kualitetit të rrethinës etj. Administrata lokale u ndihmon ndërmarrjeve në mbulimin e pjesës më të madhe të investimeve fillestare.

Në Francë jepen lirime nga tatimet për ndërmarrjet e reja të cilat hapin vende të reja të punës. Sistemi bankar në këtë shtet ndikon në përmirësimin e pozitës materiale të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Këto ndërmarrje shfrytëzojnë lehtësi tatimesh në eksport etj.

Në Suedi ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme u jepen ndihma financiare për furnizime dhe veprime të përbashkëta.

Në Gjermani ekzistojnë kryesisht dy tipe të organizatave financiare siç janë bankat dhe kursimoret. Kursimoret kreditojnë ndërmarrjet private pothuajse në të gjitha veprimtaritë ekonomike. Kursimoret i themelojnë shoqatat e veta të investimeve, fondet e specializuara për investime etj. Kursimoret zhvillojnë aktivitete financiare të huazimit financiar me afat të shkurtër për financimin e kërkesave të mallit.

Në vendet në tranzicion bankat janë të tipit universal, ato mirren me të gjitha punët bankare. Bankat punojnë përafërsisht me të njejtat norma të kamatës si dhe me dokumentacione të ngjajshme për lejimin e kredive. Bankat përcaktojnë lartësinë e kredisë, afatet e pagesës, normën e kamatës si

dhe elementet tjera të marrëdhënjeve kreditore. Bankat në këto vende janë forca kryesore e mjeteve të lira financiare afatshkurtër dhe afatgjatë dhe kreditori kryesor i bizneseve në këto vende.

Tregtia e parave organizohet vetëm për banka e jo për qarkullim në berzën e parave e cila faktikisht nuk ekziston. Koperativat kursimore nuk ekzistojnë në shumicën e shteteve në tranzicion. Sistemi i tregtimit të aksioneve të bankave dhe ndërmarrjeve funksionon pak ose nuk funksionon fare.

Bankat dhe organizatat tjera financiare në këto vende mirren edhe me ndërmjetësim në mes të blerësit dhe furnizuesit, duke gjetur ofertues të mjeteve të lira dhe kërkues të këtyre mjeteve për kreditime të biznesit. Organizatat e specializuara për lizing kanë rëndësi për menaxhimin e portofoles të letrave me vlerë, për blerjen e kërkesave nga qarkullimi afarist i mallrave dhe qarkullimi i shërbimeve.¹⁰³

Në Kosovë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të marrin kredi nga bankat dhe atë me kamatë të lartë. Si mjet garantues për marrjen e kredisë nevojitet pengu, hipoteka në vlerën për dy herë më të madhe se kredia. Kredia jepet për veprimtari të ndryshme ekonomike, si për kapital qarkullues ashtu edhe për kapital themelor. Edhe disa organizata mikrofinanciare lejojnë kredi me vlerë më të vogël se sa bankat, me kamatë të njëjtë mirëpo me afat më të shkurtër.

III.2. Zhvillimet e burimeve të financimit dhe qasja në financim në vendet në tranzicion

Në vendet në tranzicion financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme karakterizohet me kapital të kufizuar dhe bankat nga bizneset e vogla dhe të mesme kërkojnë të njëjtat kushte sikurse edhe për korporatat. Disa vende fqinje në tranzicion kanë përdorur instrumente të ndryshme financiare për bizneset. Shqipëria ka përdorur grantet, kreditë, skemat e mikrokredivë, fondet e kapitalit investiv dhe investimet me kapital të përbashkët. Në Bullgari janë përdorur kreditë, skemat e mikrokredivë dhe instrumentet garantuese. Rumania ka patur një nomenklaturë më të gjërë të instrumenteve financiare: grantet, kreditë, skemat e mikrokredivë, lizingun, kapitalin e përbashkët, faktoringun dhe bursat. Ndërkaq vendi ynë në vitet e pasluftës fillimisht ka shfrytëzuar grantet, skemat e mikrokredivë dhe në disa raste kapitalin e përbashkët.¹⁰⁴

¹⁰³ Prof.Dr.Isak Mustafa, "Konferenca e pestë ndërkombëtare biznesi dhe punësimi", 2006, Prishtinë, fq.7-10.

¹⁰⁴ Prof.dr.Isa Mustafa, Konferenca e pestë ndërkombëtare "Biznesi dhe punësimi", 2006, Prishtinë, fq.41.

IV. Roli i ndërmarrësit dhe menaxherit në zhvillimin dhe menaxhimin e burimeve të financimit

Të gjitha organizatat, pa marrë parasysh nëse janë të vogla ose të mëdha, private apo publike, profitabile apo joprofitable, pavarësisht edhe nga fusha ku veprojnë, në aktivitetin e tyre kanë një gjë të përbashkët - nevojën për t'u menaxhuar. Secila nga këto organizata për arritjen e një qëllimi, angazhon një sërë burimesh: njerëzore, materiale dhe financiare. Në këtë kontekst, menaxheri është ai që, me procesin e punës, i bashkon dhe i kordinon këto burime për arritjen e objektivave organizative.¹⁰⁵

Për të realizuar me sukses punët menaxheriale menaxheri në procesin e punës së tij ndër të tjera merr vendime edhe për burimet financiare të ndërmarrjes. Për plotësimin e detyrave të veta, për menaxhimin e burimeve të financimit, menaxheri i ndërmarrjes duhet të disponon informata relevante si nga jashtë ashtu edhe brenda ndërmarrjes.

Menaxheri financiar luan rol kyç në një firmë. Detyrat e menaxherit financiar përfshijnë buxhetin, rritjen e fondeve në tregun e kapitalit, zgjidhjen dhe vlerësimin e projekteve investive, planifikimin e strategjisë së marketingut dhe çmimeve. Menaxheri shpesh është specialist me dije nga më shumë fusha të financave, mirëpo nga ai kërkohet që, para së gjithash, të ketë ekspertizë nga fushat më të ngushta. Detyrë primare e menaxherit financiar është të parashikoj përfitimet dhe të shfrytëzoj fondet për maksimizimin e vlerës së firmës. Me një fjalë menaxheri financiar merr vendim lidhur me alternativat e burimeve dhe shfrytëzimin e fondeve.¹⁰⁶

Gjatë marrjes së vendimeve financiare menaxheri financiar duhet të siguroj mjete financiare për të mbështetur rritjen e firmës. Për lloje të ndryshme të pasurisë së firmës menaxheri financiar ka përgjegjësi të ndryshme. Menaxheri më tepër mirret me menaxhimin e pasurisë qarkulluese e më pak me menaxhimin e pasurisë fikse. Një ndër detyrat më të rëndësishme të menaxherit financiar është sigurimi i mjeteve të nevojshme financiare.

Një ndërmarrje mund të jetë e sukseshme nëse menaxhmenti rregullisht kujdeset për pozitën e sajë financiare. Menaxhmenti organizon dhe drejton punët financiare si: rrjedhën e parave, mundësitë e vetëfinansimit, shpenzimet, burimet e financimit, menaxhimin e fitimit, investimet dhe kontrollin financiar.

¹⁰⁵Dr.Ibrahim Kuka,Dr.Justina Shiroka-Pula,Mr.Besnik Krasniqi, "Menaxhmenti dhe vendosja",2006,Prishtinë, fq.21.

¹⁰⁶Prof.Dr.Isa Mustafa, "Menaxhmenti financiar"Botimi i dytë-2007,Prishtinë. fq.15.

Ndërmarrësi e orienton talentin, prirjet, dituritë, aftësitë e shkathtësitë e tij drejt shtimit të kapitalit të tij përmes realizimit të profitit. Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i ndërmarrjes janë preukopimi i tij kryesor. Kështu për realizimin e ideve apo projekteve të tij ai investon pandërprerë.

Pavarësisht nga dallimet në mes të ndërmarrësve dhe menaxherëve, si dhe vet ndërmarrësve, sipas Micheal O'Malley, ndërmarrësit janë:

- Parashikues (Envisioning): Ata i shohin gjërat që ende nuk ekzistojnë, por që do të vijnë në të ardhmen.
- “Të krisur” (Nutty): Ata dëshirojnë që njerëzit e tjerë të mendojnë për ta se janë të krisur.
- Këmbëngulës (Tenacious): Ata kacavirren kudo; për ta çdo rast është mundësi e mirë për biznes.
- Të shkathët (Resoulcesful): Nëse nuk kanë atë që u duhet, ata do të gjejnë mënyrë si ta sigurojnë.
- Energjik (Energized): Atyre nuk u duhet ora, sepse mezi presin agimin e ditës që të fillojnë punën.
- Të vendosur në qëllim (Purposeful): Ata dijnë se ku dëshirojnë të shkojnë, ndërsa e kanë planin të arrijnë atje.
- Që e marrin veten shpejt (Resilient): Ata mësojnë nga gabimet. Ata rriten nga situatat e pafavorshme – fatkeqësitë. Ata shkojnë përpara!
- Të veçantë (Exxeptional): Ata e shohin vetën si të veçantë. Ata e dijnë se kanë të drejtë.
- Negociator (Negotiators): Ata e gjejnë mënyrën që ta paguajnë Dr. E, edhe pse ende i kanë borxh Dr.S-it.
- Të ndjeshëm (Empathetic): Ata dëgjojnë për të kuptuar “midis reshtave”.
- Të kudogjendur (Ubiquitous): Ata janë kudo; janë të gjithëpranishëm.
- Revolucionar (Revolutionary): Një pjesë e gjithësisë do të jetë ndryshe, sepse një ndërmarrës është atje.¹⁰⁷

Shkurtimisht mund të thuhet se ndërmarrësi ka rolin e iniciatorit, kontrollorit, miratuesit të vendimeve, udhëheqësit të punëve dhe mbajtësit të rrezikut dhe si i tillë ai është njëri ndër faktorët e prodhimit.¹⁰⁸

¹⁰⁷ Dr.Emeric solymossy, Dr. Safet Merovci, “Ndërmarrësia”, 2006, Prishtinë, fq.15.

¹⁰⁸ Prof.Dr. Isak Mustafa, “Ndërmarrja në biznesin bashkëkohorë”, 1997, Prishtinë, fq.269.

Përfundimi

Zhvillimi i menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë mund të kontribuojë në zhvillimin efikas të bizneseve të vogla dhe të mesme në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut.

Menaxhimi i burimeve të financimit do të ndikojë në përmirësimin e pozitës materiale financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë. Menaxheri i mirë duhet praktikuar nëse sigurohen hua dhe përdoren për fitim. Një menaxhim i tillë përfshijnë: njohjen e fluksit të parave, parashikimin e nevojës për para, planifikimin e huamarrjes në një periudhë më të përshtatshme dhe vërtetimin e aftësisë paguese të biznesit.

Literatura

1. Konferenca e pestë ndërkombëtare “Biznesi dhe punësimi”, Prishtinë, 2006.
2. Kuka, Ibrahim, Justina Shiroka-Pula, Besnik Krasniqi, “Menaxhmenti dhe vendosja”, Prishtinë, 2006.
3. Mustafa, Isa, “Menaxhmenti financiar” Botimi i dytë, Prishtinë, 2007.
4. Mustafa, Isa, “Udhëheqja efiçienca dhe efektiviteti”, Prishtinë, 2004.
5. Mustafa, Isak, “Drejtori në udhëheqjen e biznesit”, Prishtinë, 1993.
6. Mustafa, Isak, “Ndërmarrja në biznesin bashkëkohorë”, Prishtinë, 1997.
7. Ramosaj, Berim, Izet Zeqiri, “Menagement”, Prishtinë, 2003.
8. Solymossy, Emeric, Safet Merovci, “Ndërmarrësia”, Prishtinë, 2006.
9. <http://sq.wikipedia.org/wiki/Menaxhimi>
10. <http://www.slideshare.net/nicky201/menaxhim-pyetje-pergjigje>